

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LAC

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Laç me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj” dhe dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 10, datë 27.01.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 324/6, datë 27.01.2012, dërguar z. **Artur BARDHI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Të nxirret shuma e pagës neto të tërhequr çdo muaj nga punonjësi ■■■ për periudhën nga 03.07.2006, datë kjo e emërimit në detyrën e specialistit të kontabilitetit, emërim ky me diplomë fallso të përfundimit të shkollës së lartë, deri me 31.12.2008, si dhe të kërkohej në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit të shkaktuar.

Menjëherë

2. Të merren masa që në preventivat për përcaktimin e vlerës limit të kontratës për punë publike, të pasqyrohet edhe fondi rezervë deri në masën deri 5 % për punime dhe volume të paparashikuara.

Vazhdimisht

3. Në prokurimet për punë publike, komisioni i vlerësimit të ofertave të ketë në përbërjen e tij specialist të fushës së ndërtimit.

Vazhdimisht

4. Në prokurimet e punëve publike, operatori ekonomik fitues para lidhjes së kontratës duhet të paraqesë Siguracionin (Polica e Sigurimit), kërkesë kjo e nenit 25 të KPK dhe nenit 6 të KVK.

Vazhdimisht

5. Të mos shqyrtohen dhe miratohen në asnjë rast leje sheshi dhe leje ndërtimi nga KRRT-ja, pa patur një Studim Urbanistik Rajonal dhe Mjedisor, të miratuar nga KRRTRSH-ja.

Vazhdimisht

6. Të mos shqyrtohen e miratohen në asnjë rast leje sheshi dhe leje ndërtimi, nga KRRT-ja, pa miratuar më parë Studimin Urbanistik Pjesor, në zbërthim dhe mbështetje të Studimit Urbanistik Rajonal e Mjedisor të miratuar nga KRRTRSH-ja.

Vazhdimisht

7. Të merren masa për të mos shqyrtuar dhe miratuar më në asnjë rast nga KRRT-ja, leje sheshi e leje ndërtimi, për investime publike pa u plotësuar dosja përkatëse me dokumentacionin e plotë tekniko- ligjor.

Vazhdimisht

8. Të merren masa për të mbajtur sipas rastit procesverbalet e piketimit të objektit, të përfundimit të themeleve, të përfundimit të karabinasë dhe të përfundimit të objektit e sistemit të jashtëm të sheshit të ndërtimit sipas projektit.

Vazhdimisht

9. Të merren masa për të mos shqyrtuar dhe dhënë leje shfrytëzimi, pa paraqitur nga subjekti ndërtues dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor.

Vazhdimisht

10. Nga Inspektorati Ndërtimor i Bashkisë, të hartohen planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit“, me ndryshime.

Menjëherë

11. Të ushtrohen kontrolle të vazhdueshme nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë Laç, për ndërtimet pa leje dhe të mos lejohet fillimi i punimeve nga ana e subjekteve pa u paisur me leje ndërtimit.

Vazhdimisht

12. Për dhënien me qira të ambienteve, duke përfshirë edhe tregun, nga ana e institucionit të evidentohen të gjitha asetet pronë publike e Bashkisë që mund të jepen me qira, të pajisen me genplanin përkatës dhe pasi të ketë vendosur këshilli bashkiak për dhënien me qira dhe nivelin e saj për m² të çdo ambienti, të lidhet kontrata me qiramarrësin duke përcaktuar qartë detyrimet e ndërsjella dhe sanksionet si dhe detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm, siç përcaktohet në VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009.

Menjëherë

13. Nga zyra e taksave vendore të bëhet rakordimi i mjeteve të transportit, duke hartuar një inventar të plotë të mjeteve në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre dhe tonazhit, si përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të MPVD dhe Ministrisë së Financave nr. 9, datë 04.02.2003 “Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit”.

Menjëherë

14. Nga ana e zyrës së taksave vendore të hartohen planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në pikën 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” .

Vazhdimisht

15. Korrespondenca ndërmjet zyrës së taksave vendore dhe Policisë së Bashkisë të bëhet zyrtarisht nëpërmjet protokollit.

Menjëherë

16. Policia Bashkiake të hartojë planin e kontrollit vjetor dhe të marrë masat që procedurat e punës të dokumentohen në mënyre shkresore, duke u bazuar në kërkesat e Kreut VII-të urdhrin

të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës”.

Menjëherë

17. Nga ana e Policisë bashkiake në bashkëpunim me Zyrën e taksave të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t’i kërkohet këshillit bashkiak, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”

Në mbledhjen e radhës

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohen në rrugë ligjore **dëmet ekonomike në vlerën totale 30,163,805 lekë**, të shkaktuara buxhetit të shtetit nga ku:

B.1. Vlera 268,363 lekë, në ngarkim të 2 punonjësve të gjendjes civile për dhënie page në kundërshtim me pikën 33, të VKM nr. 606, datë 27.04.2009 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 478, datë 18.07.2007. “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në varësi të ministrive të linjës”, i ndryshuar.

Deri në arkëtimin e plotë

B.2. Vlera 199,458 lekë, në ngarkim të 4 punonjësve që kanë përfituar pagë, për leje vjetore , në kundërshtim me kërkesat e Kreut II-të “Pushimet”, pika 2 e 3 të VKM nr. 511, datë 22.04.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar.

Deri në arkëtimin e plotë

B.3. Vlera 994,911 lekë, në ngarkim të 1 punonjësi për pagë të përfituar padrejtësisht, nëpërmjet një diplome fallco të përfundimit të shkollës së lartë.

Deri në arkëtimin e plotë

B.4. Vlera 86,850 lekë, në ngarkim të 17 punonjësve që kanë përfituar shpërblime në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për fondin e veçantë të institucioneve buxhetore” , të pikës 3 të UMF nr. 21, datë 18.09.2007, të dalë në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 dhe të pikës 3 të VKM nr. 1151, datë 25.11.2009 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.

Deri në arkëtimin e plotë

B.5. Vlera 35,000 lekë, në ngarkim të 1 punonjësi për përballimin e shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme (celular) nga shpenzimet operative të bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 8, lidhja nr. 6, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”.

Deri në arkëtimin e plotë

B.6. Vlera 128,053 lekë, në ngarkim të 3 punonjësve, të cilët në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në prokurimin me objekt “Rikonstruksion i segmentit rruga Rrëshen-Laç, kanë s’kualifikuar një operator ekonomik në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Deri në arkëtimin e plotë

B.7. Vlera 633,720 lekë (pa t.v.sh.), në ngarkim të 3 operatorëve ekonomikë, pasi nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit i administruar në dosjen teknike dhe nga matjet në vend, u konstatuan diferenca në zëra e volume të pakryera në fakt.

Operatorët ekonomikë janë:

1. [REDAKTUAR], për vlerën **222,000 lekë**, për objektin “Rikonstruksion rruga Kosova, Lagjia Nr.1”-Laç;
2. [REDAKTUAR] për vlerën **55,000 lekë**, për objektin “Rikonstruksion rruga e Poligonit”-Laç dhe
3. [REDAKTUAR] për vlerën **356,720 lekë**, për objektin “Ndërtim Shkolla 9 vjeçare Sanxhak”-Laç.

Deri në arkëtimin e plotë

B.8. Vlera 7.824.600 lekë, e cila përfaqëson vlerën e qirasë së pa paguar prej vitesh të lokalit të madh 4.032.000 lekë dhe vlerën e qirasë së pa paguar prej vitesh të lokalit të vogël 3.792.600 lekë, nga të dy përdoruesit, brenda ndërtesës së bashkisë.

Deri në arkëtimin e plotë

B.9. Vlera 13.596.600 lekë, nga familjarët që banojnë në katin e IV dhe të V të ndërtesës së bashkisë, e cila përfaqëson vlerën e qirasë së pa paguar prej vitesh të apartamenteve, nga përdoruesit, brenda ndërtesës së bashkisë.

Deri në arkëtimin e plotë

B.10. Vlera 6.673.140 lekë e cila përfaqëson vlerën e qirasë së pa paguar prej vitesh të dy lokaleve në Pallatin e Kulturës nga përdoruesi subjekti fizik [REDAKTUAR]

Deri në arkëtimin e plotë

B.11. Vlera 26.473 lekë, nga subjekti fizik [REDAKTUAR] e cila përfaqëson vlerën e qirasë së pa paguar prej vitit 2008 të ambientit kopsht çerdhe nga përdoruesi **subjekti fizik [REDAKTUAR]**

Deri në arkëtimin e plotë

C. MASA ADMINISTRATIVE.

C.I. Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” neni 15 dhe ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektoratin e Ndërtimit”, Bashkia Laç të kërkojë nga Kryinspektori i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë, të gjobisë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit, sepse: Veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja “c” dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; me pikën 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit janë:

a. ████████ në cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve në objektet “Rikonstruksion i rrugës Kosova, Lagja Nr.1” dhe “Rikonstruksion i rrugës së Poligonit”, **gjobë në masën 50,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 277,000 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën **277,000 lekë**.

b. ████████ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: “Ndërtim shkolla 9 vjeçare, Sanxhak”, **gjobë në masën 70,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 356,720 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën **356,720 lekë**.

c. ████████ në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektet: “Rikonstruksion i rrugës Kosova, Lagja Nr. 1”, “Rikonstruksion i rrugës së Poligonit” dhe “Ndërtim shkolla 9 vjeçare, Sanxhak”, **gjobë në masën 100,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerë 633,720 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën **633,720 lekë**.

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Mbështetur në Kreun VIII-të “Masat Disiplinore”, nenin 25, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", i ndryshuar dhe pikat 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

-Largim nga shërbimi civil, neni 25, pika 3, shkronja “d”

1. ████████ me detyrë specialist kontabiliteti pranë zyrës së financës, sepse:

-Nëpërmjet paraqitjes së diplomës fallco të përfundimit të shkollës së lartë pranë bashkisë, është emëruar si specialist kontabiliteti me Vendimin nr. 2, datë 03.07.2006 të Kryetarit të Bashkisë dhe është konfirmuar si nëpunës i shërbimit civil me Vendimin nr. 14, datë 31.12.2007, duke përfituar pagë në mënyrë të kundërligjshme për periudhën 03.07.2006 deri 31.12.2008 dhe për periudhën objekt kontrolli nga 01.01.2009 deri 30.09.2011 shumën neto 994,911 lekë.

-Vërejtje me paralajmërim, neni 25, pika 3, shkronja “b”

1. ████████ me detyrë përgjegjëse e zyrës së personelit sepse:

-Ka pranuar diplomë fallso të përfundimit të shkollës së lartë nga punonjësi ████████ ku nëpërmjet kësaj diplome është bërë emërimi i tij në detyrën e specialistit të kontabilitetit si dhe më vonë konfirmimi i tij si nëpunës i shërbimit civil.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Gjyrezi, Ramadan Zejnuni, Halil Isufi, Xhemal Luka dhe Besim Sinani. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia,

Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT